



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	15.03.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Youth Initiative for Human Rights
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga Youth Initiative for Human Rights me të cilën kërkohet që me datë 26 Mars 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike, Sheshi "Skënderbeu" dhe "Ibrahim Rugova".

Qëllimi i aktivitetit është informimi i të rinjve me parimet e ballafaqimit me të kaluarën dhe sigurimin e një shoqërie paqësore dhe gjithëpërfshirëse përmes vendosjes së disa pankartave.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për "Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike" me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin "Skënderbeu" dhe "Ibrahim Rugova" me datën 26 Mars 2021 sipas kërkesës së parashtruar. Pankartat e vendosura do të qëndrojnë në shesh nga data 26 Mars 2021 deri më 31 Mars 2021.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.